

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar	13. 01 2020		
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
	01-060/04	1781	Republika e Kosovës



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Raport i Tubimit me Publikun

Tubimi me publikun është mbajtur në Sallën e Kuvendit në Drenas, për shkak të mbajtës së distancës mes pjesëmarrësve dhe të pranishëm ishin; kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, drejtore të drejtorive komunale, administratorë të vendbanimeve dhe qytetarë. Tubimi me publikun është thirrur dy javë para mbajtës së takimit, ashtu siç parashihet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe është publikuar në ueb faqen zyrtare, në rrjetin social Feceko, në tabelën e njoftimeve para objektit të Komunës dhe në portale.

Tubimi me publikun ka filluar me këtë rend dite: Diskutim lidhur me aktivitetet e Komunës për punën një vjeçare të kryetarit të vitit fiskal 2020.

Tubimi me publikun ka karakterin informues për pjesëmarrësit, ku përfaqësuesit e Komunës njoftojnë për aktivitetet e Komunës gjatë këtij viti, për të arriturat dhe vështirësitë, për synimet si dhe investimet kapitale, ndërsa ju të pranishëm, mund të shtroni pyetje dhe të jepni propozime e sugjerime përfaqësuesve të zgjedhur komunal lidhur me realizimin e projekteve të planikuara për vitin dhe çështje të tjera që janë në interes të qytetarëve.

Kryetari Lladrovci i ka njoftuar të pranishmit me aktivitetet e komunës për punën njëvjeçare të vitit fiskal 2020.

Falënderoj të gjithë qytetarët, të cilët na kanë mirëkuptuar e bashkëpunuar në arritjen e qëllimeve tona të përbashkëta. Falënderoj në veçanti administratorët e vendbanimeve që pa kursyer kohën e tyre, kanë bashkëpunuar me ekzekutivin për të ju dal në ndihmë qytetarëve që të tejkalojmë sa më lehtë këtë gjendje.

Me ndihmën e administratorëve, Shtabit Emergjent Qendrës Operative Emergjente, nënshtabeve emergjente dhe me ndihmën e dhjetëra donatorëve lokal, vendor e ndërkombëtar, kemi arritur që sadopak të ju lehtësojmë gjendjen mbi 5 mijë ekonomive familjare, duke ju ndarë pako ushqimore e higjienike.

Të nderuar të pranishëm, Janë asfaltuar dhjetëra kilometra asfalt në lagje, rregullim të rrjetit të kanalizimit në shumicën e vendbanimeve, ndërtimin e kolektorëve për ujëra të zeza, ndriçim publik në shumë lagje të fshatrave, rregullim të trotuareve, ndërtimi i rrjetit elektrik në shumicën e fshatrave, renovimi i QMF-ve e AMF-ve, renovimin e të gjitha shkollave të cilat kanë pasur nevojë të riparohen. Janë krijuar kabinete të informatikës ne të gjitha shkollat, funksionalizimin thuaje i të gjitha shkollave me laboratë, vendosja e kamerave të sigurisë ne të gjitha objektet arsimore, pajisja e të gjitha shkollave me inventar, pajisja e të gjitha shkollave me laptop, projektor, tv e tableta të mençur, përkrahja e fermerëve përmes subvencionimit me pajisje të nevojshme për të ju lehtësuar punën, ndarja e serave për fermer, mirëmbajtje të rrugëve gjatë sezonit veror e dimëror, mirëmbajtja e kanalizimeve, mirëmbajtja e rrugëve të rendit të katër me zhavor, mirëmbajtja e parqeve dhe gjelbërimi i hapësirave publike. Ndërtimi i Stadionit Rexhep Rexhepi faza e dytë, ndërtimi i fushave sportive në disa vendbanime, subvencinone në sport, renovimi i stadionit sintetik dhe realizmi i dhjetëra projekteve të tjera të cilat nuk po i përmendi për shkak të kohës.

Duke marr edhe propozimet tuaja të dala nga dëgjimet buxhetore, ne kemi arritur t'i realizojmë thuajse të gjitha projektet e planikuara, prandaj ju ftoj që edhe në vitin 2021, duke shpresuar të tejkalohet gjendja nga virusi, të bashkëpunojmë për të mirën e qytetarëve, duke ju lehtësuar atyre jetën në komunitet me realizimin e projekteve.

Drejtori për Buxhet e Financa, Shyqiri Bublaku – ju kisha njoftu për buxhetin dhe zhvillimin e buxhetit në pikë të shkurta për vitin 2020. Buxheti fillestar për vitin 2020 ka qenë 16 milion e 490 mijë e 343 euro, mirëpo me angazhimin e gjithë stafit të administratës komunale, kemi arritur që buxhetin final për vitin 2020 të rrisim në 18 milion e 218 mijë e 607 euro. Trendi më i madh është rritur për investimet kapitale, ku buxheti fillestar ne këtë kategori ka qenë 4 milion e 686 mijë e 930 euro, ndërsa është rritur në 6 milion e 822 mijë e 775 euro. Shkalla e shpenzimit të buxhetit komunal ka arrit në shumën prej 82.95 për qind, por shkallë e cila do të rritet sepse pagat e muajit të 12 nuk janë proceduar ende, andaj kjo përqindje do të shkoj mbi 87 për qind. Shkalla e shpenzimit të grantit qeveritar, do të shkoj mbi 93 për qind, ndërsa shkalla e investimeve kapitale është në vlerën prej 5 milion e 034 e 939 euro, por këtu nuk figuron dhe shuma prej 119 mijë e 569 euro e cila shkallën e shpenzimit të investimeve kapitale do ta rrisë në 75.55 për qind. Kjo përqindje besoj se është mjaft e mirë, kur kemi parasysh se viti 2020 ka qenë vit pandemik dhe kjo ka ndikuar në vonimin e proceseve si të buxhetimit ashtu edhe shpenzimit të buxhetit, kur dihet se buxheti është aprovuar nga Qeveria në muajin Mars, dhe mjetet për investimet kapitale janë alokuar vetëm

50 për qind në pjesën e parë të vitit, që do të thotë se komuna ka mundur të realizoj vetëm pas 6 mujorit të dytë.

Samedin Kiqina – administratorë në fshatin Baicë ka pyetur lidhur me projektet në këtë fshat, përkatësisht lagjen Vrellaku, lagjen Elshani e disa rrugë.

“Në lagjen Vrellaku në projekt ka pasur me u shtru asfalt, në shkurt kur e kemi mbajtur një takim, na është thënë se do të kryhet asfalt, është shtruar vetëm në zhavorr, por pse nuk është shtruar asfalt kjo rrugë nuk kemi ndonjë përgjigje, nuk kemi informacion si fshat se kah janë shkuar rrjeti i kanalizimit në disa lagje, është dashur të jetë një raport se kah kanë shkuar ato rrjete te kanalizimit. Po ashtu rruga të lagja Leku është në gjendje të mjerueshme, ka pasur po ashtu edhe kjo rrugë të behët me asfalt. Të lagja Elshani qe të ne njihet si lagja e Binakve, janë 15 shtëpi që kanë nevojë për zhavorr, e kam bërë kërkesën në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, por me kanë thënë se për këtë vit është e pamundur të kryhet, mundeni me shku me i vizitu edhe vetë se në çfarë gjendje janë. Rruga “Sylë Elshani”, ka dalur një qytetarë në shtëpi të re, ka ardhur kadastra ja ka qelë rrugën, por ende nuk është shtruar rruga e tij. Në lagjen Zariqi kanë mbetur 6 familje pa krye në rrugën kryesore. Të mulliri i vjetër ka mbetur vetëm një familje pa zhavorr dhe është në gjendje të keqe. Ndriçimi i fshatit është mirë të behët, po ashtu edhe një fushë e futbollit është mirë të behët sepse ka hapësirë për t'u ndërtuar”, ka thënë Kiqina.

Lidhur me këtë pyetje dhe kërkesa është përgjigjur Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci:

Të falënderoj për bashkëpunimin e treguar, por fole për punë që nuk janë ashtu, sepse po flet për nga një shtëpi që nuk kanë zhavorr. Ne e kemi pasur një plan që e kemi vendosur së bashku me juve se cilat rrugë e projekte do të kryhen, dhe sipas atij plani edhe janë kryer të gjitha punimet e planifikuara, madje si rezultat i punëve të mira, ne kemi fituar edhe grande e donacione nga Qeveria e donatorë ndërkombëtarë për projekte. Sa i përket kanalizimit në fshatin tuaj, qe the nuk kanë marr masa, ne kemi marr masa dhe është bërë zhavori sipas planifikimit dhe kontratës së nënshkruar nga kontraktori. Nuk mundemi krejt me i ba, dikush keq pa mbet nuk e le, rruga të Lekt nuk është shtruar një pjesë, por të gjitha rrugët që kanë qenë të planifikuara janë kryer. Projekti të lagja Vrellaku është projekt dy vjeçar dhe këtë vit është shtruar në zhavor, ndërsa vitin e ardhshëm do të asfaltohet, pra projekti është dy vjeçar dhe me pas mundësinë të gjitha projektet i kisha bërë dy vjeçare, për shkak të mirëmbajtjes dhe obligimeve të operatorëve që nëse ka defekte, kompania është e detyruar të bëjë riparimet dhe të gjitha projektet kishin qenë me të mira në realizim. E përmende një shtëpi që ka mbetur në baltë, ne nuk mundemi për një shtëpi me qu asfalt e as

zhavor nëse është pronë private, por nëse ne i kemi hapur rrugën, e menjëherë nuk mundemi me shtru asfalt rrugën për një shtëpi, duhet me pas durim. Të lagja Zariqi, nuk është e vërtetë që nuk kanë dalje dhe kanë mbetur të bllokuar, ata e kanë dalje, sepse është bërë mbikalimi të stacioni i trenit dhe tani e kanë shumë më lehtë kryçjen, ata më nuk bëjnë 4 kilometra, ata pa rrugë nuk janë e kanë rrugën me dal të tunelli. Ndriçimi do të behët vitin e ardhshëm shumicën e vendbanimeve, por edhe iniciativat e vendbanimeve që behën ne i marrim përgjegjësitë e pagesës së shpenzimeve të ndriçimit, por edhe komuna me mjete të veta ka bërë ndriçim në shumë vendbanime gjatë këtij viti, duke përdorur shtyllat e reja të KEDS-it që janë vendosur gjatë këtij viti.

Murat Elshani, administrator i fshatit Gllobar – ka përmendur projektet që janë realizuar në këtë fshat, mirëpo ka kërkuar të rregullohen disa rrugica të lagjeve, si ajo në lagjen e Binakve dhe Elshani. Po ashtu, ky administrator ka përmendur edhe problemet me ndriçim.

Kryetari Lladrovci – Faleminderit Murat për vlerësimin, në fshatin tuaj janë bërë investime sikur në vendbanime të tjera, por do të punohet edhe në vitin e ardhshëm. Kemi pasur 350 mijë euro grant për me e rregullu pishat në Gllobar me trotuar e ndriçim por Ministria nuk e ka ekzekutu këtë projekt dhe e kemi dërguar në gjykatë. Sa i përket procesit të varrezave, si të marrim ligjshmërinë nga Ministria do të zgjidhet problemi i varrezave në fshatin Gllobar.

Ramadan Ramaj, nga fshati Tërdec ka parashtruar vetëm një kërkesë për vitin 2021. Ai ka ka falëndëruar për punët që janë bërë në fshatin që përfaqëson, mirëpo ka kërkuar të behët furnizimi me ujë të pijshëm për fshatin.

Kryetari Lladrovci – është problem të garantoj që të rregullohet uji i pijshëm për vitin e ardhshëm, sepse ju besoj që jeni në dijeni që në projektin paraprak nga qeverisja e kaluar, nuk janë gjetur gypat e vendosur në tokë në disa segmente dhe pa u zhvillu të gjitha procedurat në prokurori e gjykata për të filluar punimet, nuk guxojmë të fillojmë në rregullimin e këtij projekti sepse mund të shkojmë edhe ne në përgjegjës. Do të behën përpjekjet maksimale që ky problem të rregullohet gjatë vitit të ardhshëm sepse është një nga projektet më jetike për 22 fshatra. Sipas informata kemi telashe edhe në disa gypa të tjerë nuk janë vendosur fare gypat, prandaj do të bëjmë përpjekte që ta zgjidhim këtë problem.

Kadri Ajazi – Administratorë e fshatit Sankoc - janë kryer disa punë në fshatin tonë, në lagjen Gjoshi janë asfaltuar 350 metra dhe janë bërë përgatitjet për 200 metra të tjera me zhavor, dhe vendosja e një muri mbrojtës i cili e ka lehtësuar shumë gjendjen në fshatin tonë, sepse ka qenë shumë rrezik me u shemb. Sa i përket rrjetit të kanalizimit kanë mbetur mbi 2000 metra që për shkak se punimet nuk janë shkuar sipas kontratës, janë ndërprerë dhe është mirë që gjatë vitit të ardhshëm të përfundoj ky projekt i rrjetit të kanalizimit. Sa i përket drejtorisë së Shërbimeve Publike, sa herë që kemi pasur kërkesa, na u kanë përgjigjur dhe kanë qenë shumë bashkëpunues, edhe drejtoria e Arsimit shkollën e fshatit e ka pajisur me të gjitha kabinetet dhe infrastrukturën përcjellëse dhe tani shkolla thuaje është e kompletuar çka nuk ka qenë më herët në këtë gjendje dhe ju falënderojmë si fshat për të gjitha investimet që kanë bërë në fshatin tonë. Kemi hale punë në fshatin tonë për t'u kryer, është siç e përmenda rrjeti i kanalizimit, trotuare në disa pjesë të rrugëve, ndriçimi publik, e nevojën me të madhe e kemi për ujë të pijshëm. Po ashtu kemi edhe rrëth 1500 metra të rrugicave që janë në nevojshme, është në rrugën që lidhet me shkollën. Po ashtu kemi probleme edhe me qentë endacak.

Kryetari Lladrovci – ju kisha kërkuar të gjithëve, që kur të bëni kërkesa në secilën drejtori, të më njoftoni edhe mua, sepse kur i shoh problemet e juaja unë i shtyej proceset. Sa i përket kanalizimit në fshatin tuaj në Sankoc, kam kërkuar falje publike që ju e keni parë të gjithë, sepse kompania e kontraktuar nuk i ka përmbrushur punimet sipas kontratës së nënshkruar dhe ne jemi detyruar që t'i ndërprenë kontratën dhe punët dhe janë procedura që deri në pranverë nuk mund të fillojnë punimet. Më mirë është të shtyhen një vjet projekte, sepse të kryhen keq dhe të mos jenë pastaj në funksion. Sa i përket qenve endacak, është përgjegjësi e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë, kemi probleme me qentë endacak por nuk është në kompetencën tonë kjo qeshjet sepse shteti i ka dhënë të drejtën AVUK-ut për të trajtuar këtë problem.

Samedin Kiqina – kisha dasht me ditë, se kompanitë që i kryejnë punimet në terren, a janë të obliguara të kthejnë gjendjen siç ka qenë më herët. Kemi dy vende kur është pre rruga edhe është dëmtuar e nuk është kthyer në gjendje të mëparshme. Sa i përket zhavorit në rrjetin e kanalizimit, ai nuk është kryer siç duhet, prandaj duhet të shtohet kontolle ndaj punëkryesve dhe punimet kur të kryhen të kthehen në gjendje të mëparshme.

Ramiz Lladrovci – prandaj po kërkojë nga ana juaj të bashkëpunoni me mua të jem i njoftuar për secilin problem që ju e paraqitni sepse menjëherë do të marrim masa, nëse është punë që kryhet me ligj, ne do të kryejmë secilin problem që shfaqet në punimet që kryhen në vendbanime. Pa juve, unë e kisha pas vështirë të kryej të gjitha punët, prandaj jam shumë mirënjohës nga ana juaj për bashkëpunimin që keni treguar,

kemi shembullin e fundit për menaxhimin e pandemisë, ne ju kemi besuar detyrën e juaj dhe të gjitha ndihmat që janë ndarë me pako ushqimore janë ndarë sipas listave që ju i keni dërguar dhe qohem në kam për punën dhe bashkëpunimin që keni treguar gjatë kësaj kohe, ju kemi ngarkuar me shumë se që duhet, por të gjithë, pa përjashtim, keni qenë shumë bashkëpunues.

Gazmend Hajdini – administrator i fshatit Zabel i Lartë – në fshatin tonë është bërë ndriçimi, janë bërë edhe disa kërkesa për disa rrugica për asfaltim të rrugëve që kanë nevojë. Ju kisha falënderuar shumë që keni bashkëpunuar me neve dhe janë kryer shumë punë. Ka mbetur një pjesë e asfaltimit të këtij fshati dhe kisha pyetur a ka me u kry rruga gjatë vitit të ardhshëm.

Kryetari Lladrovci – vitin e ardhshëm është në projekt që ajo pjesë që ju po e tregoni përfshatin Zabel do të kryhet. Sa i përket ndriçimit që e përmende, ne kemi punuar ne shumë rrugë ku janë bërë më ndriçim, i kemi shfrytëzuar shtyllat ku janë vendosur të reja, por edhe vullnetin e banorëve që marrin iniciativa për të rregulluar ne marrim përgjegjësinë për t'i paguar pastaj faturat e shpenzimeve që kryhen përfshim. Kemi në plan të kryejmë shumë ndriçime edhe vitin e ardhshëm, por aty ku nuk mundemi të bëjmë si komunë, është mirë të merrni vetë masa e iniciativa sepse ne marrim përsipër pagesën e shpenzimit që behët.

Zekë Kluna – administrator i fshatit Poklek i Vjetër – kam bërë disa kërkesa në drejtori, sepse kemi tri rrugica pa shtruar, ku janë rrugët me emrat e martirëve, kanë mbetur disa metra pa u kry në këto rrugë, po ashtu edhe të uji i thartë është mirë të behët intervenim.

Kryetari Lladrovci – ato tri rrugë, kemi pyetur dhe kemi vërtetuar se janë rrugë private, në rrugët private, mundemi me shtru zhavor, por jo asfalt, sepse duhet vetë pronarët të kthejnë nga prona private të bëjnë rrugë publike, pastaj mundemi me asfaltu. Ligji nuk na lejon që në rrugët private të shtrohet asfalt. Kryetari ka përshëndetur të gjithë të pranishmit që kanë gjetur mundësinë të jenë pjesë e këtij tubimi përfundvit dhe ka uruar festat me dëshirën që viti 2021 të jetë me shëndet e suksese përfshirë të gjithë dhe ka falënderuar përfshirë bashkëpunimin e treguar gjatë këtij viti, duke shpresuar që bashkëpunimi të vazhdoj edhe në vitin e ardhshëm përfshirë të mirën e qytetarëve.

Të gjitha pyetjet e administratorëve kanë marrë përgjigjen e Kryetarit të Komunës, z.Ramiz Lladrovci.

Takimi ka përfunduar në ora 11:05. Pjesëmarrës ishin 42 vetë. Më gjërësisht, takimi është në audio incizim.

Raportin e hartozi:

Bekim Dobra, Shef i Zyrës së Informimit

(Handwritten signature)



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuesi	130121		
Nj. Org.	Numër	Shtoja	Vlera
01.06.04.178 Republika e Kosovës			
Komuna e Drenasit			
Zyra e Kryetarit			
Drenas, më 13.01.2021			

Logo of the Municipality of Glllogoc:



PROCESVERBAL

i Tubimit me Publikun

Tubimi me publikun është mbajtur në Sallën e Kuvendit në Drenas, për shkak të mbajtës së distancës mes pjesëmarrësve dhe të pranishëm ishin; kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, drejtori të drejtorive komunale, administratorë të vendbanimeve dhe qytetarë. Tubimi me publikun është thirrur dy javë para mbajtës së takimit, ashtu siç parashihet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe është publikuar në ueb faqen zyrtare, në rrjetin social Fecekoos, në tabelën e njoftimeve para objektit të Komunës dhe në portale.

Tubimi me publikun ka filluar me këtë rend dite: Diskutim lidhur me aktivitetet e Komunës për punën një vjeçare të kryetarit të vitit fiskal 2020.



Tubimin me publikun e ka hapur Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, **Bekim Dobra** i cili edhe ka treguar arsyen e thirrjes së këtij takimi. Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje Lokale, Komuna është e obliguar të mbaj dy tubime me publikun, njërin pas përfundimit të gjashtëmujorit të parë, të vitit fiskal dhe tjetri në fundvit, këtë që sot po e mbajmë. Për këtë tubim, Komuna ka bërë me kohë njoftimin dhe ka publikuar dy javë para në ueb faqe të Komunës, në rrjetin social të Komunës, njoftimi është vendosur edhe ne dy hyrjet e objektit të Komunës, është vendosur edhe ne vendet me të frekuentuara si dhe në mediat

online. Po ashtu janë kontaktuar të gjithë administratorët e fshatrave. Ndjej për obligim të ju njoftoj për rregullat e takimit. Tubimi me publikun ka karakterin informues për pjesëmarrësit, ku përfaqësuesit e Komunës njoftojnë për aktivitetet e Komunës gjatë këtij viti, për të arriturat dhe vështirësitë, për synimet si dhe investimet kapitale, ndërsa ju të pranishëm, mund të shtroni pyetje dhe të jepni propozime e sugjerime përfaqësuesve të zgjedhur komunal lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara për vitin dhe çështje të tjera që janë në interes të qytetarëve.

Kryetari Lladrovci – Ju faleminderit që keni gjetur kohën të jeni sot pjesëmarrës në këtë tubim me publikun, tubim ky përmbyllës për këtë vit. Ndonëse një vit me plot sfida e vonesa në realizim të planifikimeve, të shkaktuar nga pandemia globale e virusit covid-19, ne me të gjitha kapacitetet jemi munduar që të gjitha projektet të cilat kanë qenë të planifikuara të realizohen sipas planifikimit.

Falënderoj të gjithë qytetarët, të cilët na kanë mirëkuptuar e bashkëpunuar në arritjen e qëllimeve tona të përbashkëta. Falënderoj në veçanti administratorët e vendbanimeve që pa kursyer kohën e tyre, kanë bashkëpunuar me ekzekutivin për të ju dal në ndihmë qytetarëve që të tejkalojmë sa më lehtë këtë gjendje.

Me ndihmën e administratorëve, Shtabit Emergjent Qendrës Operative Emergjente, nënshtabeve emergjente dhe me ndihmën e dhjetëra donatorëve lokal, vendor e ndërkombetar, kemi arritur që sadopak të ju lehtësojmë gjendjen mbi 5 mijë ekonomive familjare, duke ju ndarë pako ushqimore e higjenike.

Falënderoj për bashkëpunim gjatë këtij viti për të tejkular gjendjen nga virusi, Stacionon Policor në Drenas, punonjësit shëndetësor, zjarrfikësit, punonjësit e administratës komunale, njësinë e Pastrimit e Ujësjellësit në Drenas, KEDS-in dhe gjithë qytetarët e Drenosit.

Po e përmbyllim një vit me shumë suksese, duke u shpallur komuna me performancën me të mirë në nivel vendi, me përfitim të grantit mbi 800 mijë euro, të vlerësuar nga tri Ambasadat me kredibile në vend. Mjetet e këtij granti janë shfrytëzuar në realizim të projekteve për të mirën e komunitetit. Po e mbyllim këtë vit, duke realizuar mbi 90 për qind të buxhetit të komunës, ndonëse me shumë vonesa në shpalljen e tenderëve për shkak të pandemisë.

Të nderuar të pranishëm, Janë asfaltuar dhjetëra kilometra asfalt në lagje, rregullim të rrjetit të kanalizimit në shumicën e vendbanimeve, ndërtimin e kolektorëve për ujëra të zeza, ndriçim publik në shumë lagje të fshatrave, rregullim të trotuareve, ndërtimi i rrjetit elektrik në shumicën e fshatrave, renovimi i QMF-ve e AMF-ve, renovimin e të gjitha shkollave të cilat kanë pasur nevojë të riparohen. Janë krijuar kabinete të informatikës ne të gjitha shkollat, funksionalizimin thuaje i të gjitha shkollave me laboratë, vendosja e kamerave të sigurisë ne të gjitha objektet arsimore, pajisja e të gjitha shkollave me inventar, pajisja e të gjitha shkollave me laptop, projektor, tv e tableta të mençur, përkrahja e fermerëve përmes subvencionimit me pajisje të nevojshme për të ju lehtësuar punën, ndarja e serave për fermer, mirëmbajtje të rrugëve gjatë sezonit veror e dimëror, mirëmbajtja e kanalizimeve, mirëmbajtja e rrugëve të rendit të katër me zhavor, mirëmbajtja e parqeve dhe gjelbërimi i hapësirave publike. Ndërtimi i Stadionit Rexhep Rexhepi faza e dytë, ndërtimi i fushave sportive në disa vendbanime, subvencione në sport, renovimi i stadionit sintetik dhe realizmi i dhjetëra projekteve të tjera të cilat nuk po i përmendi për shkak të kohës.

Të nderuar të pranishëm,

Duke marr edhe propozimet tuaja të dala nga dëgjimet buxhetore, ne kemi arritur t'i realizojmë thuajse të gjitha projektet e planifikuara, prandaj ju ftoj që edhe në vitin 2021, duke shpresuar të tejkalohet gjendja nga virusi, të bashkëpunojmë për të mirën e qytetarëve, duke ju lehtësuar atyre jetën në komunitet me realizimin e projekteve.

Ju faleminderit për vëmendjen!

Drejtori për Buxhet e Financa, Shyqiri Bublaku – ju kisha njoftu për buxhetin dhe zhvillimin e buxhetit në pikë të shkurta për vitin 2020. Buxheti fillestar për vitin 2020 ka qenë 16 milion e 490 mijë e 343 euro, mirëpo me angazhimin e gjithë stafit të administratës komunale, kemi arritur që buxhetin final për vitin 2020 të rrisim në 18 milion e 218 mijë e 607 euro. Trendi më i madh është rritur për investimet kapitale, ku buxheti fillestar ne këtë kategori ka qenë 4 milion e 686 mijë e 930 euro, ndërsa është rritur në 6 milion e 822 mijë e 775 euro. Shkalla e shpenzimit të buxhetit komunal ka arrit në shumën prej 82.95 për qind, por shkallë e cila do të rritet sepse pagat e muajit të 12 nuk janë proceduar ende, andaj kjo përqindje do të shkoj mbi 87 për qind. Shkalla e shpenzimit të grantit qeveritar, do të shkoj mbi 93 për qind, ndërsa shkalla e investimeve kapitale është në vlerën prej 5 milion e 034 e 939 euro, por këtu nuk figuron dhe shuma prej 119 mijë e 569 euro e cila shkallën e shpenzimit të investimeve kapitale do ta rrisë në 75.55 për qind. Kjo përqindje besoj se është mjaft e mirë, kur kemi parasysh se viti 2020 ka qenë vit pandemik dhe kjo ka ndikuar në vonimin e proceseve si të buxhetimit ashtu edhe shpenzimit të buxhetit, kur dihet se buxheti është aprovuar nga Qeveria në muajin Mars, dhe mjetet për investimet kapitale janë alokuar vetëm 50 për qind në pjesën e parë të vitit, që do të thotë se komuna ka mundur të realizoj vetëm pas 6 mujorit të dytë.

Samedin Kiqina – administratorë në fshatin Baicë – ka përvendetur takimin dhe ka thënë se shumë punime në fshatin Baicë janë kryer dhe ka falënderuar komunën, megjithatë ka thënë se disa prej punimeve nuk janë kryer siç duhet. Ka probleme në realizimin e punimeve, i kam përcjellë me foto të gjitha projektet ku kam vërejtur defektet, por nuk e di pse nuk janë marr masat. Në lagjen Vrellaku në projekt ka pasur me u shtru asfalt, në shkurt kur e kemi mbajtur një takim, na është thënë se do të kryhet asfalt, është shtruar vetëm në zhavorr, por pse nuk është shtruar asfalt kjo rrugë nuk kemi ndonjë përgjigje, nuk kemi informacion si fshat se kah janë shkuar rrjeti i kanalizimit në disa lagje, është dashur të jetë një raport se kah kanë shkuar ato rrjete te kanalizimit. Po ashtu rruga të lagja Leku është në gjendje të mjerueshme, ka pasur po ashtu edhe kjo rrugë të behët me asfalt, por nuk u ba kurrgjë. Po ashtu në lagjen Topalli është shtruar asfalti, por ka mbetur vetëm një shtëpi pa zhavorr dhe është mirë të kryhet sepse është ajo familje në gjendje jo të mirë financiare, të paktën ne zhavor. Të lagja Elshani qe të ne njihet si lagja e Binakve, janë 15 shtëpi që kanë nevojë për zhavorr, e kam bërë kërkesën në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, por me kanë thënë se për këtë vit është e pamundur të kryhet, mundeni me shku me i vizitu edhe vetë se në çfarë gjendje janë. Rruga "Sylë Elshani", ka dalur një qytetarë në shtëpi të re, ka ardhur kadastra ja ka qelë rrugën, por ende nuk është shtruar rruga e tij. Në lagjen Zariqi kanë mbetur 6 familje pa kyçje në rrugën kryesore. Të mulliri i vjetër ka mbetur vetëm një familje pa zhavorr dhe është në gjendje të keqe. Ndriçimi i fshatit është mirë të behët, po ashtu edhe një fushë e futbollit është mirë të behët sepse ka hapësirë për t'u ndërtuar.

Kryetari Lladrovci – të falënderoj për bashkëpunimin e treguar, por fole për punë që nuk janë ashtu, sepse po flet për nga një shtëpi që nuk kanë zhavorr. Ne e kemi pasur një planë që e kemi vendosur së bashku me juve se cilat rrugë e projekte do të kryhen, dhe sipas atij plani edhe janë kryer të gjitha punimet e planifikuara, madje si rezultat i punëve të mira, ne kemi fituar edhe grande e donacione nga Qeveria e donatorë ndërkombëtarë për projekte. Sa i përket kanalizimit në fshatin tuaj, qe the nuk kanë marr masa, ne kemi marr masa dhe është bërë zhavori sipas planifikimit dhe kontratës së nënshkruar nga kontraktori. Nuk mundemi krejt me i ba, dikush keq pa mbet nuk e le, rruga të Lekt nuk është shtruar një pjesë, por të gjitha rrugët që kanë qenë të planifikuara janë kryer. Projekti të lagja Vrellaku është projekt dy vjeçar dhe këtë

vit është shtruar në zhavor, ndërsa vitin e ardhshëm do të asfaltohet, pra projekti është dy vjeçar dhe me pas mundësinë të gjitha projektet i kisha bërë dy vjeçare, për shkak të mirëmbajtjes dhe obligimeve të operatorëve që nëse ka defekte, kompania është e detyruar të bëjë riparimet dhe të gjitha projektet kishin qenë me të mira në realizim. E përmende një shtëpi që ka mbetur në baltë, ne nuk mundemi për një shtëpi me qu asfalt e as zhavor nëse është pronë private, por nëse ne i kemi hapur rrugën, e menjëherë nuk mundemi me shtru asfalt rrugën për një shtëpi, duhet me pas durim. Të lagja Zariqi, nuk është e vërtetë që nuk kanë dalje dhe kanë mbetur të bllokuar, ata e kanë dalje, sepse është bërë mbikalimi të stacioni i trenit dhe tani e kanë shumë më lehtë kryçjen, ata më nuk bëjnë 4 kilometra, ata pa rrugë nuk janë e kanë rrugën me dal të tunelli. Ndriçimi do të behët vitin e ardhshëm shumicën e vendbanimeve, por edhe iniciativat e vendbanimeve që behën ne i marrim përgjegjësitë e pagesës së shpenzimeve të ndriçimit, por edhe komuna me mjete të veta ka bërë ndriçim në shumë vendbanime gjatë këtij viti, duke përdorur shtyllat e reja të KEDS-it që janë vendosur gjatë këtij viti.

Murat Elshani, administrator i fshatit Gllobar – në disa debate gjatë këtij viti, nuk kam mundur të prezantoj, por deshta të paraqes punët që janë kryer në fshatin Gllobar. Në fshatin tonë është punuar mjafsheshëm, është rregulluar pjesa e kanalizimit thuajse në gjithë fshatin, e po ashtu edhe rrugët në secilën lagje, trotuari është rregulluar në pjesët me të frekuentuara, rregullimi i rrjetit të energjisë elektrike, shkolla e fshatit është modernizuar me të gjitha pajisjet e nevojshme, trotuare, fusha sportive, rregullim të brendshëm të shkollës. Puna dhe dora e komunës shihet në fshatin tonë. Është bërë intervenimi të shtëpia e Zymer Elshanit ku është rregulluar që ka qenë një problem që sa vite. Fshati Gllobar ka ende disa probleme me disa rrugica të lagjeve, në lagjen e Binakve dhe lagjen Elshani dhe lagjen rrugën që lidhet me fshatin Vërboc. Po ashtu kemi nevojë me të madhe për ndriçim. Kur është bërë pastrimi i lumit, një pjesë e dheut ka mbetur keq dhe është mirë që të largohet ai dhe.

Kryetari Lladrovci – faleminderit Murat për vlerësimin, në fshatin tuaj janë bërë investime sikur në vendbane të tjera, por do të punohet edhe në vitin e ardhshëm Kemi pasur 350 mijë euro grant për me e rregullu pishat në Gllobar me trotuar e ndriçim por Ministria nuk e ka ekzekutu këtë projekt dhe e kemi dërguar në gjykatë. Sa i përket procesit të varrezave, si të marrim ligjshëmrinë nga Ministria do të zgjidhet problemi i varrezave në fshatin Gllobar.

Ramadan Ramaj, nga fshati Tërdec – Ju kisha falënderu për punët që janë bërë në fshatin tonë, si në asfaltimin e rrugëve, rrjetin e kanalizimit e po ashtu edhe ndriçimi në disa lagje, por kemi vetëm një kërkesë si banorë që për vitin 2021 të behët furnizimi me ujë të pijshëm për fshatin tonë.

Kryetari Lladrovci – është problem të garantoj që të rregullohet uji i pijshëm për vitin e ardhshëm, sepse ju besoj që jeni në dijeni që në projektin paraprak nga qeverisja e kaluar, nuk janë gjetur gypat e vendosur në tokë në disa segmente dhe pa u zhvillu të gjitha procedurat në prokurori e gjykata për të filluar punimet, nuk guxojmë të fillojmë në rregullimin e këtij projekti sepse mund të shkojmë edhe ne në përgjegjës. Do të behën përpjekjet maksimale që ky problem të rregullohet gjatë vitit të ardhshëm sepse është një nga projektet më jetike për 22 fshatra. Sipas informata kemi telashe edhe në disa gypa të tjerë nuk janë vendosur fare gypat, prandaj do të bëjmë përpjeke që ta zgjidhim këtë problem.

Kadri Ajazi – Administratorë e fshatit Sankoc - janë kryer disa punë në fshatin tonë, në lagjen Gjoshi janë asfaltuar 350 metra dhe janë bërë përgatitjet për 200 metra të tjera me zhavor, dhe vendosja e një muri mbrojtës i cili e ka lehtesar shumë gjendjen në fshatin tonë, sepse ka qenë shumë rrezik me u shemb. Sa i përket rrjetit të kanalizimit kanë mbetur mbi 2000 metra që për shkak se punimet nuk janë shkuar sipas kontratës, janë ndërprerë dhe është mirë që gjatë vitit të ardhshëm të përfundoj ky projekt i rrjetit të kanalizimit. Sa i përket drejtorisë së Shërbimeve Publike, sa herë që kemi pasur kërkesa, na u kanë përgjigjur dhe kanë qenë shumë bashkëpunues, edhe drejtoria e Arsimit shkollën e fshatit e ka pajisur me të gjitha kabinetet dhe infrastrukturën përcjellëse dhe tani shkolla thuaje është e kompletuar çka nuk ka qenë më herët në këtë gjendje dhe ju falënderojmë si fshat për të gjitha investimet që kanë bërë në fshatin tonë. Kemi hale punë në fshatin tonë për t'u kryer, është siç e përmenda rrjeti i kanalizimit, trotuare në disa pjesë të rrugëve, ndriçimi publik, e nevojën me të madhe e kemi për ujë të pijshëm. Po ashtu kemi edhe rreth 1500 metra të rrugicave që janë në nevojshme, është në rrugën që lidhet me shkollën. Po ashtu kemi probleme edhe me qentë endacak.

Kryetari Lladrovci – ju kisha kërkuar të gjithëve, që kur të bëni kërkesa në secilën drejtori, të më njoftoni edhe mua, sepse kur i shoh problemet e juaja unë i shtyej proceset. Sa i përket kanalizimit në fshatin tuaj në Sankoc, kam kërkuar falje publike që ju e keni parë të gjithë, sepse kompania e kontraktuar nuk i ka përmbrushur punimet sipas kontratës së nënshkruar dhe ne jemi detyruar që t'i ndërpremë kontratën dhe punët dhe janë procedura që deri në pranverë nuk mund të fillojnë punimet. Më mirë është të shtyhen një vjet projektet, sepse të kryhen keq dhe të mos jenë pastaj në funksion. Sa i përket qenve endacak, është përgjegjësi e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë, kemi probleme me qentë endacak por nuk është në kompetencën tonë kjo qeshjet sepse shteti i ka dhënë të drejtën AVUK-ut për të trajtuar këtë problem.

Samedin Kiqina – kisha dasht me ditë, se kompanitë që i kryejnë punimet në terren, a janë të obliguara të kthejnë gjendjen siç ka qenë më herët. Kemi dy vende kur është pre rruga edhe është dëmtuar e nuk është kthyer në gjendje të mëparshme. Sa i përket zhavorit në rrjetin e kanalizimit, ai nuk është kryer siç duhet, prandaj duhet të shtohet kontolle ndaj punëkryesve dhe punimet kur të kryhen të kthehen në gjendje të mëparshme.

Ramiz Lladrovci – prandaj po kërkojë nga ana juaj të bashkëpunoni me mua të jem i njoftuar për secilin problem që ju e paraqitni sepse menjëherë do të marrim masa, nëse është punë që kryhet me ligj, ne do të kryejmë secilin problem që shfaqet në punimet që kryhen në vendbanime. Pa juve, unë e kisha pas vështirë të kryej të gjitha punët, prandaj jam shumë mirënjoës nga ana juaj për bashkëpunimin që keni treguar, kemi shembullin e fundit për menaxhimin e pandemisë, ne ju kemi besuar detyrën e juaj dhe të gjitha ndihmat që janë ndarë me pakoh që janë ndarë sipas listave që ju i keni dërguar dhe qohem në kam për punën dhe bashkëpunimin që keni treguar gjatë kësaj kohe, ju kemi ngarkuar me shumë se që duhet, por të gjithë, pa përjashtim, keni qenë shumë bashkëpunues.

Gazmend Hajdini – administrator i fshatit Zabel i Lartë – në fshatin tonë është bërë ndriçimi, janë bërë edhe disa kërkesa për disa rrugica për asfaltim të rrugëve që kanë nevojë. Ju kisha falënderuar shumë që keni bashkëpunuar me neve dhe janë kryer shumë punë. Ka mbetur një pjesë e asfaltimit të këtij fshati dhe kisha pyetur a ka me u kry rruga gjatë vitit të ardhshëm.


Kryetari Lladrovci – vitin e ardhshëm është në projekt që ajo pjesë që ju po e tregoni për fshatin Zabel do të kryhet. Sa i përket ndriçimit që e përmende, ne kemi punuar ne shumë rrugë ku janë bërë më ndriçim, i kemi shfrytëzuar shtyllat ku janë vendosur të reja, por edhe vullnetin e banorëve që marrin iniciativa për të rregulluar ne marrim përgjegjësinë për t'i paguar pastaj faturat e shpenzimeve që kryhen për ndriçim. Kemi në plan të kryejmë shumë ndriçime edhe vitin e ardhshëm, por aty ku nuk mundemi të bëjmë si komunë, është mirë të merrni vetë masa e iniciativa sepse ne marrim përsipër pagesën e shpenzimit që behët.

Zekë Kluna – administrator i fshatit Poklek i Vjetër – kam bërë disa kërkesa në drejtori, sepse kemi tri rrugica pa shtruar, ku janë rrugët me emrat e martirëve, kanë mbetur disa metra pa u kry në këto rrugë, po ashtu edhe të uji i thartë është mirë të behët intervenim.

Kryetari Lladrovci – ato tri rrugë, kemi pyetur dhe kemi vërtetuar se janë rrugë private, në rrugët private, mundemi me shtru zhavor, por jo asfalt, sepse duhet vetë pronarët të kthejnë nga prona private të bëjnë rrugë publike, pastaj mundemi me asfalt. Ligji nuk na lejon që në rrugët private të shtrohet asfalt. Kryetari ka përshëndetur të gjithë të pranishmit që kanë gjetur mundësinë të jenë pjesë e këtij tubimi përfundvit dhe ka uruar festat me dëshirën që viti 2021 të jetë me shëndet e suksese përfundit të gjithë dhe ka falenderuar përfundit të bashkëpunimin e treguar gjatë këtij viti, duke shpresuar që bashkëpunimi të vazhdoj edhe në vitin e ardhshëm përfundit.


Takimi ka përfunduar në ora 11:05. Pjesëmarrës ishin 42 vetë. Më gjërësisht, takimi është në audio incizim.

Procesmbajtësi:


Bekim Dobra



Kryetari Komunës


Ramiz Lladrovci